

INFORMACIONE ME KARAKTER PUBLIK

Në bazë të nenit 9 nga Ligji i Qasjes së Lirë deri te Informacionet me Karakter Publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 13/2006, 86/2008, 6/10 , 42/14, 148/15 dhe 55/16”), Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore publikon:

LISTËN E INFORMACIONEVE ME KARAKTER PUBLIK

me të cilat disponon Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore

Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore disponon me këto informacione me karakter publik që duhet të jenë të arritshme për kërkuesit e informacioneve sipas Ligjit të Qasjes së Lirë deri te Informacionet me Karakter Publik:

1. Ligje me të cilat rregullohen kushtet dhe mënyra e menaxhimit, planifikimit, ndërtimit, rindërtimit, mirëmbajtjes, mbrojtjes, financimit dhe mbikëqyrjes së rrugëve shtetërore si dhe themelimin dhe menaxhimin e Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore:

- Ligji i Rrugëve Publike

- Ligji i Ndërmarrjeve Publike

2. Akte që dalin nga Ligji i Rrugëve Publike, me të cilat rregullohen dhe përpunohen dispozita të caktuara nga Ligji i Rrugëve Publike, lidhur me ndërtimin, menaxhimin, mbrojtjen, pagesën e pikave pagesore, menaxhimin me rrugë publike si dhe themelimin e NPRRSH-së:

- Rregullore për mënyrën e shpërndarjes së mjeteve të komunave përkatësisht Qytetit të Shkupit, nga kompensimi për përdorimin e rrugëve shtetërore për automjetet motorike dhe lidhëse, që poseduesit e automjeteve motorike e paguajnë gjatë regjistrimit.

- Vendimi për shumën e kompensimit për vendosjen e mbishkrimeve dhe tabelave reklamuese në pjesën e mbrojtur, lidhja me rrugë të kalueshme, vendosje të instilacioneve në pjesën kryesore të rrugës dhe zonën rrugore, ndërtimi dhe përdorimi i objekteve komerciale ku lejohet qasja në rrugën publike jashtë vendbanimit, për përdorim të shumtë, për transport të jashtëzakonshëm dhe për dëmin e shkaktuar në rrugë dhe në objektet e rrugës.

- Rregullore për mënyrën e mbrojtjes së rrugëve publike
- Rregullore për mënyrën, procedurën dhe kushtet me të cilat Agjencia e Rrugëve Shtetërore i jep pëlqim për ndërtimin e rrugës shtetërore një investitori tjetër
- Rregullore për masat e mirëmbajtjes së rrugëve publike, mënyrën dhe afatet për realizimin e tyre si dhe llojin dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve për mirëmbajtje të rregullt, gjatë dimrit, mirëmbajtje periodike dhe intervenuese të rrugëve publike
- Vendimi për vërtetimin e kriterëve për kategorizimin e rrugëve publike dhe shenjat e tyre
- Rregullore për mënyrën e identifikimit të rrugëve publike me sistem përkatës referent dhe stacionazhi
- Rregullore për kriteret e përcaktimit të rrugëve në vendbanime që do të konsiderohen si pjesë e rrugës shtetërore dhe mirëmbajtja e tyre

- Rregullore për elementet teknike për ndërtimin dhe rindërtimin e rrugëve publike dhe objekteve në rrugë
- Rregullore për kërkesat teknike të sistemeve, pjesëve përbërëse, njësive të pavarura teknike, pajisjes, dimensioneve, masave të përgjithshme dhe ngarkesa e boshtit të automjeteve
- Vendim për shumën dhe mënyrën e pagesës së kompensimit për përdorimin e rrugëve publike për automjete motorike dhe lidhëse (taksa rrugore) (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.118/09 më 28.9.2009)
- Vendim për shumën dhe mënyrën e pagesë së kompensimit për përdorimin e rrugës (pikës pagesore) (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 89/09 më 20.7.2009)
- Vendim për shumën e kompensimit për vendosjen e mbishkrimeve dhe tabelave reklamuese në pjesën mbrojtëse të rrugës shtetërore, për lidhjen e rrugës dytësore në rrugë shtetërore, vendosjen e instalimeve në pjesën kryesore të rrugës dhe zonën rrugore të rrugës shtetërore, ndërtimi dhe shfrytëzimi i objekteve komercial ku lejohet qasja në rrugë publike jashtë vendbanimit, për përdorim të rrugës shtetërore, për transport të jashtëzakonshëm dhe për dëmtim të rrugës shtetërore si dhe objekteve në rrugë (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr.139/2008)
- Vendim për themelimin e Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore nr.41-10147/1 më 20.12.2012, i publikuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” nr. 1/13 më 2.1.2013
- Vendim për kategorizimin e rrugëve shtetërore (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 133/2011)
- Korrigjimi i Vendimit për kategorizimin e rrugëve shtetërore (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr.150/2011)

3. Aktet juridike me të cilat rregullohet organizimi i brendshëm dhe puna e Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore:

- Vendimi për themelimin e Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore
- Statuti i ndërmarrjes publike
- Kodi i sjelljes së punonjësve në njësinë e arkëtimit në pikat pagesore
- Organogrami i ndërmarrjes publike

4. Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore, në pajtim me Ligjin e Rrugëve Shtetërore, jep:

- Kërkesa për kthimin e mjeteve nga kompensimi për rrugë, që paguhet gjatë regjistrimit të automjeteve motorike dhe lidhëse
- Leje për vendosjen e instalimeve në pjesën mbrojtëse të rrugës
- Leje për vendosjen e tabelave reklamuese (bilborde) në pjesën mbrojtëse të rrugës
- Leje për transport të jashtëzakonshëm nëpër rrugë shtetërore

5. Programi vjetor për ndërtimin, rindërtimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore, me të cilin zbatohen qëllimet dhe detyrat e programit pesëvjeçar për ndërtimin, rindërtimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore.

6. Programi pesëvjeçar për ndërtimin, rindërtimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore për periudhën 2013 - 2017

7. Programi për ndryshimin e programit pesëvjeçar për ndërtimin, rindërtimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore për periudhën 2013 - 2017.

8. Raportet e revizionit nga Enti Shtetëror i Revizionit

9. Raportet e revizionit nga kompanitë e pavarura të revizionit

10. Plani i prokurimeve publike

11. Njoftimet dhe lajmërimet e publikut për aktivitetet dhe projektet aktuale

12. Ankandet publike aktuale

13. Harta rrugore e Republikës së Maqedonisë

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë mund të marrin informacione me karakter publik të përgatitura ose me të cilat disponon Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore duke plotësuar- Kërkesë për qasje në informacione me karakter publik, të cilat mund të gjenden në arkivin e Ndërmarrjes Publike së Rrugëve Shtetërore ose për ta shkarkuar nga linku i mëposhtëm.

Kërkesa për informacion mund të dorëzohet me shkrim në adresën e Ndërmarrjes Publike së Rrugëve Shtetërore rruga. "Dame Gruev" nr.14, 1000 Shkup, në e-mailin e personave zyrtarë për ndërmjetësim me informacione, si dhe në faks - (02) 3220-535. Qytetarët mund të informohen për të gjitha çështjet me interes për ta e që kanë të bëjnë me të drejtën për qasje të lirë në informacione me karakter publike nëpërmjet telefonit: (02) 3228 454 ose (02) 3228 044.

Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore, në pajtim me nenin 8 të Ligjit të Qasjes së Lirë në Informacione me Karakterit Publik për persona zyrtarë për ndërmjetësim me informacione, ka përcaktuar:

1. Zhaklina Vellçkovskën– Këshilltare e marrëdhënieve me publikun

e-mail: z.velickovska@roads.org.mk

2. Mekanizmi për ankesa nga realizimi i projekteve të NP së Rrugëve Shtetërore:

Contact email: gragjani@roads.org.mk

Këtu mund të shkarkoni formularin për dorëzimin e ankesave në formatin pdf.